



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 1585/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Shoqëria “K... – C...” sh.p.k me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Kimete Gashi – Brajshori, avokate nga Prishtina, kundër debitorit: Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS Sh.A, me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Kllinton, nr.3, ndërtesa e Elektrokosovës dhe debitorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a, me seli në Prishtinë sheshi Nëna Terezë, nr.36, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të dytë, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.36/2022 të datës 02.02.2022 të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.36/2022 të datës 02.02.2022 të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.36/2022 i datës 02.02.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.
- III. DETYROHEN debitorët që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ia paguajnë kreditorit në mënyrë solidare shumën prej 468.00 € (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat Destan Bujupaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, Shoqëria “K... – C...” sh.p.k, e përfaqësuar nga avokate Kimete Gashi Brajshori, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Ekonomike III EK.nr.173/21 i datës 14.07.2021 ka nxjerr urdhrin P.nr.36/2022 me datën 02.02.2022, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbarimit, ndaj debitorëve Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS Sh.a dhe Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a, me të cilën janë detyruar debitorët që të ia paguajnë kreditorit në afatin prej 7 ditëve në mënyrë solidare borxhin në shumën prej 7,871.70 euro, me kamatë vjetore sipas lartësisë së mjeteve të deponuara në bankë mbi një vit, duke filluar prej datës 08.10.2014 e deri në pagesën definitive, shumën prej 270.40 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS Sh.A, nuk ka paraqitur prapësim ndaj Urdhrit Përmbarimor, ndërsa nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës, rezulton se urdhrin P.nr 36/22 të datës 02.02.2022, e ka pranuar me datën 07.02.2022.

Debitori Korporata Energjetike e Kosovës – KEK Sh.A, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se urdhri për përmbarim është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pasi që propozimit për përmbarim nuk i është bashkangjitur dokumenti përmbareues konform nenit 36 të LPP-së dhe është në kundërshtim me nenin 38 të LPP-së, duke theksuar që debitori i dytë Korporata Energjetike e Kosovës prej datës 08.05.2013 nuk ka nën menaxhim Divizionin e Rrjetit dhe Furnizimit, duke shtuar se përgjegjësinë për kthimin e mjeteve të parapagimit dhe mundësinë e transferimit të mjeteve nga një shifër në shifrën tjetër dhe çdo marrëdhënie detyrimore me të gjitha të drejtat dhe obligimet kanë kaluar nga KEK në KEDS.

I ka propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri i propozuar për përmbarim P.nr.36/2022 të datës 02.02.2022 si dhe të pezullohen të gjitha veprimet e ndërmarra ndaj debitorit KEK.

E autorizuar e kreditorit, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe se të

njëjtat janë të pabazuara, duke shtuar se debitori nuk ka pranuar të bëjë përmbushjen vullnetare të detyrimit edhe pas zhvillimit të takimeve me përfaqësuesit e debitorit, ka theksuar se pretendimet e debitorit që prej datës 08.05.2013 nuk e kanë nën menaxhim Divizionin e Rrjetit dhe Furnizimit, janë sqaruar në procedurën kontestimore ku është vendosur me aktgjykim e formës së prerë, dhe se debitori përveç që nuk e ka përmbush në mënyrë vullnetare detyrimin e tij ende vazhdon me kundërshtime duke zvarritur procedurën me qëllim të ikjes së përmbushjes së detyrimeve. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pa bazuar si dhe i ka kërkuar shpenzimet në shumën prej 468 euro për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit Korporata Energjetike e Kosovës – KEK Sh.a, të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit Korporata Energjetike e Kosovës – KEK Sh.a, është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbartuesit Privat P.nr. 36/2022 të datës 02.02.2022, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) – aktgjykimit i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike III Ek.nr.173/2021, datë 14.07.2021, aktgjykim i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 14.12.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 20.01.2022

Sipas dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.173/21 debitorët janë detyruar që në mënyrë solidare kreditorit t'ia kthejnë mjetet e parapaguara për shkak të mos shpenzimit të energjisë elektrike në shumën prej 7.871.70 euro, me kamatë si për mjetet e deponuara në kursim mbi një vit pa destinim të caktuar, nga data e paraqitjes së padisë me datën 08.10.2014 e deri në pagesën definitive. Si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 270.40 euro, nën kërcenim të përmbartimit me detyrim.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbartimor – aktgjykimi i lartcekur është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit–vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë: *“vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbartueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbartim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – Aktgjykimin i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbartues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Ekonomike III Ek.nr. 173/2021 i datës 14.07.2021 është i përmbartueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbartim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitorët, është përcaktuar

shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorëve si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit Korporata Energjetike e Kosovës – KEK Sh.a, se *“propozimi për përmbarim nuk i është bashkangjitur dokumenti përmbarues konform nenit 36 të LPP-së dhe është në kundërshtim me nenin 38 të LPP-së”*, dhe gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar, meqenëse në shkresa të lëndës dokumenti përmbarimor përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III Ek.nr. 173/2021 i datës 14.07.202 - në bazë të së cilës është caktuar urdhri është i dorëzuar në origjinal.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimin e debitorit se që nga data 13.05.2021 nuk e ka nën menaxhim Divizionin e Rrjetit dhe Furnizimit dhe se përgjegjësia për kthimin e mjeteve të parapagimit dhe mundësinë e transferimit të mjeteve nga një shifër në shifrën tjetër dhe çdo marrëdhënie detyimore me të gjitha të drejtat dhe obligimet kanë kaluar nga KEK në KEDS dhe gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi në procedurën përmbarimore dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë për shkak të parimit të rigorozitetit forma, në bazë të së cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit i cili është objekt i përmbarimit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 par.4 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 468.00 € (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë euro), siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 39, 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1585/22 dt. 30.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes kësaj Dhome.